



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:220905

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05518661

**P.nr./..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit F..B.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2149/22 të datës 25.10.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 28.03.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr./.. e datës 20.02.2024, lidhur në mes të pandehurit F..B.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2149/22 të datës 25.10.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit F..B.., i lindur me ..... në P..., ku edhe jeton rr “ M... A... “ nr..., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, posedon numër të telefonit ..... , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 25.10.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.2149/22 ndaj të pandehurit F..B.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 20.02.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit F..B.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P.., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 20.02.2024, lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:220905, 28.03.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gj y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

\_\_\_\_\_  
Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi